

11. REZYME

Kosova është një vend i vogël. Duke ju falënderuar pozitës gjeografike, faktorëve gjeologjik, pedologjik, hidrologjik, reliivi dhe klimës, ka diversitet të pasur biologjik dhe peizazhor me një llojllojshmëri të mirë floristike, vegjetative dhe faunistike. (MMPH-AMMK, 2010).

Bazuar në hulumtimet e deritanishme, fitodiversiteti i Kosovës është mjaft i pasur. Ka mendime se në kuadër të florës vaskulare në Kosovë janë prezent afér 2800-3000 lloje bimore (Millaku, F. et al 2013).

Kjo pasuri floristike është e shpërndarë në ekosisteme të ndryshme, por edhe përgjatë rrjedhave të lumenjve.

Lumi Drenicë me rrjedhën e tij në pjesën nga Karaçica deri në Shtrubullovinë kalon nëpër teritorin e vendbanimeve të cilat në organizimin administrative u përkasin tri komunave (Shtime, Lipjan dhe Drenas). Ujërat e lumbit Drenicë derdhen në Lumin Sitnicë i cili përmes lumbit Ibër vazhdon rrjedhën e tin deri në Detin e Zi (Rexhepi, F. 1994).

Lokalitetet ku janë realizuar hulumtime në kuadër të rrjedhës së lumbit Drenicë nga Karaçica deri në Shtrubullovinë janë lokalitetet Karaçicë, Krojmir, Nekoc, Komoran, Zabel i Ultë dhe Shtrubullovinë.

Sipas metodologjisë së hulumtimit të vegjetacionit nga Braun Blanquet 1964 (Rexhepi, F. 1982, 1994), vegjetacioni përgjatë pjesës e hulumtar të rrjedhës së lumbit Drenicë mbulohet me shumicë nga formacionet pyjore shkurrore me *shelg*. Këto fragmente, i takojnë klasës *Querco-Fagetea*, rendit *Populetalia albae* dhe aleancës *Salicion albae*. Në pjesë më të vogla, në zonën malore gjenden disa fragmente me *verr tē zi* të cilat i takojnë klasës *Alnetea glutinosae*, rendit *Alnetalia glutinosae* dhe aleancës *Alnion glutinosae*.

Vegjetacioni i zonës jashtë rrjedhës ujore të lumit Drenicë, në pjesën më të madhe mbulohet nga pyjet, livadhet dhe agroekosistemet. Pyjet janë gjetherënëse nga klasa *Querco-Fagetea*, t' rendeve *Quercetalia pubescentis* e *Fagetalia sylvaticae* dhe nga aleancat *Quercion petraeae-cerris* dhe *Fagenion moesiaca*. Livadhet mbulohen nga vegjetacioni barishtor i klasës *Molinio-Arrhenatheretea*, nga rendi *Trifolio hordeatalia* dhe aleanca *Trifolion resupinati*. Pjesë e konsiderueshme mbulohet edhe nga agroekosistemet. Nëpër livadheve dhe agroekosisteme, ka fragmente të vogla nga fitocenoza *Crataego-Prunetum spinosae* të klasës *Querco-Fagetea* nga rendi *Prunetalia spinosae* dhe aleanca *Berberion vulgaris* (Hundozi, B. 1980, Rexhepi, F. 1994, Krasniqi, E. 2006).

Në zonën e hulumtuar ka veprimitari të ndryshme antropogjene, të cilat shpesh manifestohen në aspektin negativ. Degradimi i pyllit afër vendburimeve ujore, zjarret, ndërhyrjet në shtratin e lumit, hedhja e mbeturinave etj., janë disa nga veprimet të cilat e degradojnë rrjedhën e lumit dhe e dëmtojnë diversitetin biologjik dhe peizazhor. Kjo veprimitari ndikon negativisht në fisionominë dhe në biodiversitetin përgjatë rrjedhës së lumit.

Qëllimi kryesor për realizimin e këtij punimi është hulumtimi florës vaskulare, ndërsa është e rendësishme se është hulumtimi pare i këtij lloji në këtë rrjedhën e lumit Drenicë nga burimi e tij deri në Shtrubullovinë.

Bazuar në të dhënrat nga Harta Pedologjike e Kosovës, rrjedha e lumit kalon nëpër tipe të ndryshme të tokave (Çavolli, R, Pavičević, N. et al. 1974). Klima është kontinentale me temperaturë mesatare vjetore rreth 9.6°C dhe të reshura mesatare vjetore prej rreth 692 mm Kojic, M. & Pejcinovic, D. 1982).

Hulumtimi është realizuar në vitin 2023, kryesisht gjatë muajve Prill-Korrik. Me qëllim të dokumentimit të rezultateve, është mbledhur material floristik i mjaftueshëm për dokumentim. Për përcaktimin e llojeve bimore, për analizën e formave korologjike si dhe për analizën e formave jetësore bimore, janë përdorur përcaktues respektivisht tekste e punime të autorëve të ndryshëm.

Se zona e hulumtuar është e pasur në aspektin floristik, pasqyrohet përmes pranisë së llojeve bimore të cilat u takojnë formave të ndryshme korologjike dhe biologjike. Në veçanti të rendësishme përrjedhat ujore janë llojet bimore ujore.

Bazuar në identifikimin e 119 llojeve bimore nga grapi i bimëve *Pteridophyta* dhe *Magnoliophyta*, të përfaqësuara nga forma të larmishme korologjike dhe biologjike, mund të

konkludojmë se rrjedha e lumbit Drenicë, në pjesën e hulumtuar (Karaçicë-Shtribullovë), me diversitetin e tij floristik, ka rol me rendësi në trashëgiminë natyrore të Kosovës.

Pasi që ky është hulumtim i parë aspektin floristik në këtë pjesë të rrjedhës së lumbit Drenicë, është e pamundur të bëhen krahasime me rezultate të hulumtimeve të mëparme.

Edhe pse presioni nga faktori antropogen ekziston në vazhdimësi (diku më shumë e diku më pak) në rrjedhën e lumbit, ai me aktivitetin e tij ende reziston duke pasqyruar pamjen e tij si ekosistem. Edhe pse gjatë stinës së verës, gjatë periudhës me thatësi më të theksuar, vjen momenti kur volumi i rrjedhës ujore pakësohet, prapseprapë lumi me rrjedhën që mbetet e ruan fizionominë dhe funksionin e tij si ekosistem.